



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:172811
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06293789

Ca.nr.1749/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Malsor Kryeziu – anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.S, F.K dhe H.F të gjithë nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Lutfi Tahiri me seli të zyrës në Prishtinë, rruga “Garibaldi” nr.61, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.990/21, të datës 08.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.990/21, i datës 08.12.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.990/21, të datës 08.12.2023 ka vendosur “*në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësve F.S, F.K dhe H.F të gjithë nga Vushtrria dhe detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që:-Paditëses F.S, në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 12.03.2020 e deri me datë 26.03.2021, (142 ditë pune), t’ia paguaj shumën prej 284.00 euro, -Paditëses F.K, në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 12.03.2020 e deri me datë 26.03.2021, (58 ditë pune), t’ia paguaj shumën prej 116.00 euro,-Paditësit H.F, në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 12.03.2020 e deri me datë 26.03.2021, (142 ditë pune), t’ia*

paguaj shumën prej 284.00 euro, për të gjithë paditësit me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (04.08.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës, dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 dhe për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 228.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta anulon dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore ose aktgjykimin e atakuar të prish dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësit nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se:

- Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre me datë 04.08.2021, kanë ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti për kompensim të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Vushtrrisë, që t'ua kompensoj ushqimin-shujtat për ditët e pranisë në punë, për periudhat dhe shumën e specifikuar si në kërkesëpadi, me kamatë ligjore prej 8%, nga paraqitja e padisë si dhe i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve për të njëjtat arsye si në ankesë, duke propozuar refuzimin e të njëjtës.

Gjykata e shkallës së parë, në fazën e përgatitjes së lëndës për shqyrtim kryesor të çështjes, pas vlerësimit të deklarimeve të ndërgjyqësve dhe fakteve jokontestuese në mes tyre si dhe provave në shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 398 të LPK-së, ka vendosur jashtë seancës aktgjykimin e goditur duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar, e në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 8 par.1 dhe nenit 245, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të dt.22.01.2021.Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se, përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në këtë kontest është i qartë dhe i kuptueshëm si në pjesën e arsytimit ashtu edhe në dispozitiv, ku figuron e qartë dhe e kuptueshme mënyra e vendosjes. Dispozitivi është edhe i ekzekutueshëm. E drejta materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë, gjë që ka rezultuar me miratimin e drejtë të kërkesëpadisë së paditësve në shumën e gjykuar, e që ky aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 398, të LPK-së, dhe nenit 452 të LPK-së prandaj i njëjti vërtetohet në tërësinë e tij.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ca.nr.1749/24 me datë 10.10.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Enes Mehmeti